



**AGJENCIA  
KOMBËTARE  
E DIASPORËS**



**AGJENCIA  
KOMBËTARE  
E DIASPORËS**



**AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS**

**UNIVERSITETI HUMANITAR  
SHTETËROR I IZMAILIT**

## **MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS**

**DHE**

**UNIVERSITETIT HUMANITAR SHTETËROR TË IZMAILIT**

**2020**



## PREAMBUL

Agjencia Kombëtare e Diasporës, (qyteti Tiranë, Shqipëri) dhe Universiteti Humanitar Shtetëror i Izmailit (qyteti Izmail, Ukrainë), të cilët në vijim do të quhen *Palë*:

duke njohur rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit dypalësh, bashkëpunimit me shoqatat kombëtare-kulturore të shqiptarëve të Ukrainës dhe me vëndin e origjinës - Shqipërinë;

*për të evidentuar* kontributin që ka komuniteti shqiptar i Ukrainës në ruajtjen e gjuhës shqipe, kulturës, traditave dhe trashëgimisë kulturore shqiptare në shekuj pa pasur një lidhje të vazhdueshme me vëndin e origjinës - Shqipërinë;

*me qëllimin* për të nxitur organizimin e aktiviteteve të përbashkëta;

*duke afirmuar vullnetin* dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar me qëllimin e realizimit të këtij memorandumi në përmbushjen e angazhimeve të paraqitura në ligjin Shqiptar nr. 115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”;

palët ranë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi, i quajtur në vijim Memorandumi.

### **Neni 1** **Qëllimi**

1.1. Palët angazhohen të krijojnë Qendrën e Informacionit të Shqipërisë (e quajtur në vijim - Qendra) me qëllim harmonizimin dhe forcimin e bashkëpunimit dypalësh. Kjo marrëveshje përfshin të drejtat dhe detyrimet e Palëve për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës në përputhje me legjislacionin aktual të Ukrainës.

1.2. Qendra e Informacionit të Shqipërisë - është një njësi e ngritur në bazë të vullnetit të palëve me qëllimin për të bashkëpunuar dhe ushtruar aktivitetet në kuadër të veprimtarive të Agjencisë Kombëtare për Diasporën dhe të Universitetit Humanitar Shtetëror të Izmailit, sipas përcaktimit të pikës 1.1 të këtij neni.

### **Neni 2** **Detyrat e Qendrës**

2.1. Aktivitetet kryesore të Qendrës:

- 2.1.1 organizimi dhe kryerja e eventeve që synojnë forcimin e bashkëpunimit dypalësh, mësimin e gjuhës shqipe, zhvillimin e kulturës dhe traditave kombëtare të popullit shqiptar;
- 2.1.2 informimin e qytetarëve të Ukrainës për ngjarjet kryesore në sferat publike sociale, ekonomike, kulturore, arsimore të Shqipërisë;
- 2.1.3 krijimin e kushteve për studimin e gjuhës shqipe nga studentë, mësues si dhe grupe të interesuara nga jugu i rajonit të Odesës;
- 2.1.4 fillimin dhe realizimin e projekteve të diplomacisë publike dhe kulturore;
- 2.1.5 bashkëpunim me qendrat e Informacionit të shteteve të tjera në kuadër të projekteve të Universitetit Humanitar Shtetëror të Izmailit;



- 2.1.6 bashkëpunimin me institucionet shqiptare për Diasporën për realizimin e detyrave kryesore dhe misionit të saj;
- 2.1.7 zhvillimin e eventeve të tjera nga Qendra në përputhje me kompetencat e saj në kuadër të legjislacionit në fuqi të Ukrainës dhe akteve ligjore ndërkombëtare të ratifikuara nga Ukraina.

### Neni 3

#### Përgjegjësitë e palëve

##### **3.1 Universiteti Humanitar Shtetëror i Izmailit do të sigurojë:**

- 3.1.1. vënien në dispozicion të informacionit për aktivitetet e Qendrës me të gjitha mjetet që ka në dispozicion, të cilat nuk janë të ndaluara nga legjislacioni i Ukrainës;
- 3.1.2 caktimin e një personi përgjegjës nga punonjësit e tij për menaxhimin e Qendrës (në cilësinë e administratorit/asistentit laboratorik) i cili është dhe përgjegjës për sigurinë e pajisjeve të Qendrës;
- 3.1.3 dhënien e ambientit/auditorit të mësimit falas për aktivitetin e Qendrës në ndërtesën e Universitetit Humanitar Shtetëror të Izmailit (12, rruga Repina, rajoni i Odesës, qyteti Izmail, Ukrainë), në kohën e lirë nga aktivitetet e planifikuara të Qendrës, Universiteti Shtetëror Humanitar i Izmailit ka të drejtë të zhvillojë orë mësimi në këtë ambient/auditor mësimi të Qendrës në prani të administratorit/asistentit laboratorik përgjegjës;
- 3.1.4 pagesën e shpenzimeve për shërbimet komunale lokale (ngrohje, energji elektrike);
- 3.1.5 sigurimin e një qasje të hapur në informacione rreth veprimtarive të Qendrës në faqen e tij zyrtare;
- 3.1.6 marrjen në dorëzim dhe përdorimin e materialeve dhe pajisjeve të siguruar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, vetëm për aktivitetin e Qendrës;
- 3.1.7 informimin e rregullt ndaj Agjencisë Kombëtare të Diasporës për ngjarjet dhe aktivitetet e organizuara nga Qendra.

##### **3.2 Agjencia Kombëtare e Diasporës do të sigurojë:**

- 3.2.1 dhënien e botimeve të shtypura dhe elektronike, simboleve shqiptare për Qendrën;
- 3.2.2 dhënien e programeve softuer për mësimin e gjuhës shqipe;
- 3.2.3 dhënien e mobiljeve, pajisjeve teknike për mirëfunksionimin e Qendrës (sipas Aneksit 1 të bashkëngjitur) me transferim të mëtejshëm në bilancin e Universitetit Humanitar Shtetëror të Izmailit në përputhje me legjislacionin aktual të Ukrainës;
- 3.2.4 bashkëpunimin me Universitetin Humanitar Shtetëror të Izmailit për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta.

### Neni 4

#### Zbatimi i memorandumit

- 4.1 Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkarisht zbatimin e Memorandumit nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti periodik me shkrim, në përfundim të çdo viti kalendarik.



4.2 Raporti përmban, krahas të dhënave për ecurinë e aktiviteteve trajnuese të zhvilluara gjatë vitit kalendarik edhe rekomandime konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara. Raporti publikohet në faqet zyrtare të Palëve.

#### **Neni 5**

##### **Komunikimi mes palëve**

5.1 Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion, të domosdoshëm për përmbushjen e detyrimeve të tyre. Komunikimi i vazhdueshëm do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike, në gjuhën angleze. Në çdo rast palët angazhohen të japin përgjigje brënda 10 ditëve.

5.2 Palët angazhohen të jenë gjithmonë të disponueshëm për komunikimin me njëra-tjetrën me qëllim koordinimin dhe rakordimin e veprimeve në secilin rast konkret.

#### **Neni 6**

##### **Kohëzgjatja e Memorandumit dhe ndryshimet e tij**

6.1. Ky memorandum nuk është një traktat ndërkombëtar.

6.2. Palët mund të tërhiqen nga kjo marrëveshje duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën gjashtë muaj përpara.

6.3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me marrëveshje të palëve. Këto ndryshime duhet të miratohen me shkrim dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve.

#### **Neni 7**

##### **Hyrja në fuqi e Memorandumit**

Memorandumi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 6 (gjashtë) kopje autentike, dy prej të cilave në gjuhën ukrainase, dy kopje në gjuhën shqipe dhe dy kopje në gjuhën angleze. Në rast mosmarrëveshje midis palëve b ze. Termat dhe efektet ligjore të përdorura në redaktimin e kësaj Marrëveshjeje përputhen plotësisht me kërkesat e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar dhe Ukrainas.

**Agjencia  
Kombëtare e Diasporës**

**Drejtori Ekzekutiv**

**Sonila Hysi**

**Universiteti humanitar  
Shtetëror i Izmailit**

**Rektori**

**Jaroslav Kiçuk**